



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2022:130092

Datë: 20.12.2022

Numri i dokumentit: 03776752

P.nr.102/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC/Departamenti i Përgjithshëm–Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Mizahir Shabani, me sekretaren juridike Shemsije Shehu, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarit S. S., nga Rahoveci, për shkak të veprës penale Sulm nga neni 184 par.3 nënpar.3.1 e lidhur me par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Gjakovë/Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.788/2022 të datës 21.06.2022, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar dhe publik, në prezencën e përfaqësuesit të akuzës Prokurori i Shtetit Enis Gashi, të akuzuarit, dhe përfaqësuesit ligjorë të të miturit, më datë 19.12.2022, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari,

S. S., nga i ati B., e ëma J., e lindur P., i lindur më datë ..., në Rahovec, ku edhe banon, punëtor, i martuar i ati i pesë (5) fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal ..., serb, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me datë 27.04.2022 rreth orës 18:30, në lagjen e Epërme në Rahovec, saktësisht afër fushës së futbollit, me dashje përdor forcën ndaj personit tjetër të dëmtuarit / të mitur I. H. - viktimë e ndjeshme, në atë mënyrë që si rrjedhojë e mosmarrëveshjeve të vazhdueshme që kishin fëmijët e të pandehurit me të dëmtuarin, ashtu që ditën kritike deri sa i dëmtuari ka qenë duke luajtur me top me fëmijët e të pandehurit, dhe pasi që ngacmohen në mes vete, ku fëmijët e të pandehurit i tregojnë për këtë problem, i pandehuri i revoltuar me këtë shkon në fushën e futbollit ku kanë qenë fëmijët duke luajtur, dhe po sa e sheh të dëmtuarin e sulmon fizikisht duke goditur me duar në fytyrë përkatësisht në faqe, e pastaj e hekë atleten nga këmba dhe e gjuan të dëmtuarin ku e godet në shpin dhe këmbën e majtë dhe më pas e kap për veshi dhe e dërgon deri te dyqani i tij, me ç'rast të dëmtuarit i shkakton dhembje dhe shqetësim emocional.

Me këto veprime ka kryer veprën penale Sulm nga neni 184 par.3 nënpar.3.1 e lidhur e par.1 të KPRK-së,

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave të neneve 4, 6, 7, 17, 38, 46 par.1 pika 1.1, 47, 48, 49, 69, 70, nenit 184 par.3 nënpar.3.1 e lidhur e par.1 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIMIN ME KUSHT

Dënimin me burgim në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë (90) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afat prej një (1) viti, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Përfaqësuesi i të dëmtuarit I. H., i ati R. H., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Detyrohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumë prej tridhjetë (30) Euro, në emër të ekspertizës shumë prej njëzetë (20) Euro, si dhe për fondin e kompensimit të viktimave të krimit shumë prej tridhjetë (30) Euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

1.Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.788/2022 të datës 21.06.2022, kundër të pandehurit S. S., nga Rahoveci, për shkak të veprës penale Sulm nga neni 184 par.3 nënpar.3.1 e lidhur e par.1 të KPRK-së

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar me datë 19.12.2022, ku prezent kanë qenë përfaqësuesi i akuzës Prokurori i Shtetit Enis Gashi , i akuzuari si dhe përfaqësuesi ligjorë i të miturit, babai R. H..

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit i cili ka qëndruar në tërësi pranë saj, i akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën për të cilën akuzohet.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ka dhënë mundësinë e pranimit ose mospranimit të fajësisë, si dhe gjykata e ka njoftuar lidhur me efektet dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

I akuzuari deklaroi se e pranon fajësinë sipas të gjitha pikave të aktakuzës, e ndjen veten fajtor për këtë vepër penale për të cilën ngarkohet dhe se ndjen keqardhje për rastin që ka ndodhur, i premtori gjykatës se nuk do ta përsërit veprën penale për të cilën ngarkohet, i propozon gjykatës që të ketë mirëkuptim në shqiptimin e dënimit.

Prokurori i Shtetit Enis Gashi, ka dhënë mendimin lidhur me pranimin e fajësisë, i cili ka deklaruar se: nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi që pranimin e fajësisë e ka bërë me vullnet të lirë, dhe pasi i ka kuptuar të drejtat, respektivisht favoret dhe pasojat e pranimi të fajësisë, po ashtu duke marrë për bazë se aktakuza ka mbështetje në provat materiale dhe personale në bazë të të cilave është paraqitur gjendja faktike në dispozitiv të saj, ku edhe përmbushen të gjitha elementet e veprës penale për të cilat ngarkohet i akuzuari. I propozoj gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të njëjtit ti shqiptojë një dënim të paraparë ligjor, duke marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë dhe rrezikshmërisë së veprës penale për të cilën ngarkohet.

Përfaqësuesi ligjor i të miturit, babai R. H. deklaroi se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensimin e dëmit për dëmin e shkaktuar pasi që nga dita kritike nuk kanë pasur ndonjë problem me të akuzuarin si dhe i kanë raportet e rregulluara.

Gjykata konform dispozitave të nenit 365 të KPPK-së, e pasi që janë plotësuar kushtet e parapara sipas dispozitave të nenit 326 të njëjtit Kod, për shkak se i akuzuari në fillim të seancës të shqyrtimit fillestar është deklaruar i fajshëm, në tërësi ka pranuar veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata nuk është lëshuar në procedurën e administrimit të provave.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike: - se i akuzuari S. S., me dashje ka kryer veprën penale Sulm nga neni 184 par.3 nënpar.3.1 e lidhur e par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 184 par.3 nënpar.3.1 e lidhur e par.1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale Sulm e kryen: “ **Kur vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet ndaj viktimës së ndjeshme ose është e motivuar sipas kombësisë, gjuhës, besimit fetar ose mungesës së besimit fetar, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, ose për shkak të afërsisë me persona me njërin nga këto karakteristika të mbrojtura, kryesi dënohet me burgim deri në tre (3) vjet për veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni dhe Kushdo që me dashje përdor forcën ndaj personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit**”

5. Vendimet e gjyqtarit të vetëm gjykues

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas pranimit të fajësisë nga i akuzuari, ka gjetur se i njëjti ka kryer veprën penale Sulm nga neni 184 par.3 nënpar.3.1 e lidhur e par.1 të KPRK-së, dhe gjendjen e tillë faktike e mori ashtu sikurse ishte përcaktuar në aktakuzë dhe provat të cilat i përmbante aktakuza, e të cilat janë:

- Raporti i hetuesit A. B. me nr.4869 të datës 27.04.2022;
- Ekspertiza mjeko-ligjore e Dr. V. K/ të datës 03.06.2022;
- Deklarata e përfaqësuesit ligjor prindi i të dëmtuarit të mitur R. H. e dhënë në Stacionin Policor në Rahovec me datë 27.04.2022;

- Deklarata e të pandehurit S. S. e dhënë në polici të datës 27.04.2022;
- Një (1) CD me video incizime;

Gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata ka vendosur ta shpallë fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e caktimit dhe matjes së dënimit gjykata ka marrë parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit sipas nenit 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ashtu që si rrethanë lehtësuese ka marrë sjelljen korrekte të të akuzuarit në gjykim, është penduar për veprimin e bërë, është hera e parë që ndeshet me ligjin, i njëjti është deklaruar i fajshëm, se i vjen keq për rastin e ndodhur, si dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë një veprim të tillë, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti, andaj të njëjtit ia ka shqiptuar dënimin me kusht me shpresë dhe bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë me dispozitat e nenit 38 të KPRK-së.

7. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit që kërkesën pasurore – juridike ta realizojë në procedurën e rregullt civile, bazohet në nenin 463 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u mor konform nenit 450 paragrafi 1 dhe 2 nënparagrafi 2.6, lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPK-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u mor në kuptim të nenit 39 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit Nr.05/L – 036, për kompensimin e viktimave të krimit.

Nga sa u tha më lartë e në vështrim të nenit 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.102/2022, me datë 19.12.2022

Gjyqtari i vetëm gjykues
Mizahir Shabani

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit, nëpërmjet kësaj gjykate për gjykatën e Apelit në Prishtinë.